

Bazuar në nenin 6, të Ligjit nr.20/2025 “Për paketën e maleve”, ku përcaktohet se rregullat e hollësishme për mënyrën e paraqitjes së aplikimit dhe procedurat e brendshme administrative për zbatimin e këtij neni pranë bashkive, përcaktohen me udhëzim të kryetarit të bashkisë, në varësi të rrethanave të posaçme të secilës zonë, është miratuar Udhëzimi nr.1, datë 21.09.2026, nr.12544 prot., datë 21.09.2026 nga Kryetarja e Bashkisë Durrës.

Ky udhëzim hartohet në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.20/2025, “Për paketën e maleve”, ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.182, datë 19.03.2026 “Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Durrës” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive”.

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes së aplikimit/kërkesës dhe procedurën e brendshme administrative që do të ndiqet nga Bashkia për njohjen e subjekteve si posedues jopronar në zonat e shpallura si zona zhvillimi.

Në kuadër të këtij procesi, Bashkia Durrës, ka si objektiv kryerjen e procedurave administrative në njohjen e subjekteve kërkuese si posedues jopronar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi duke u udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, transparencës dhe mbrojtjen e interesit publik.